



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **39**

Prishtinë, më 19.3.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Myrvete Pantina, Hestet Cakolli, Elhëme Hetemi, Ali Lajçi, Berat Luzha, Dragiša Mirić.

Munguan : Zef Morina, Selvie Halimi (pushim lindjes), Naim Maloku (udhëtim zyrtar) Zulfi Merxha (ka arsyetuar mungesën).

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga MMPH-Naser Balaj dhe këshilltarja e Ministrit, nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj si dhe zyrtarët nga USAID-Haxhi Gashi dhe z. Bill..

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku

Mbledhjen e kryesoi : Lulzim Zeneli, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i nenit 11.1 i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.
3. Shqyrtimi i propozimit të komisionit për buxhet për një takim të përbashkët rreth dy projektligjeve në procedurë.
4. Shqyrtimi i projektligjit për produktet Biocide.

Kryesuesi Lulzim Zeneli konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Stafi : Për shkak të urgjencës së hartimit të amendamenteve, në procesverbalin e fundit është lënë pa u shënuar fakti se me iniciativën e Berat Luzhës është hequr fjalia e fundit në Amendamentin 1 për projektligjin për Bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe Amendamenti 7

për financimin dhe agjencinë e pagesave është hartuar me sponsorimin dhe propozimin e zyrtarëve nga OSCE.

2..Shqyrtimi i nenit 11.1 i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të Ndotjes

Lulzim Zeneli theksoi në fillim arsyet për çfarë është shtyre pika e rendit të ditës në seancën e fundit plenar rreth miratimit të amendamenteve për këtë projektligj. Ai tha se atë ditë kur u deshtë të bëhet leximi i dytë, u sugjerua (nga kabineti i kryetarit, ministrit përkatëse dhe miqtë ndërkombëtar) që neni 11.1 të rishikohet dhe të fshihet mundësisht, ngase është dhe do të jetë në të ardhmen pengesë për zhvillimin ekonomik të Kosovës, ndaj konsideroj ai, se kjo çështje kërkon edhe qëndrimin politik.

Përfaqësuesi i USAID-it z. Bill, lavdëroi këtë projektligj por ai tha se duhet të përmirësohet sa i përket përkufizimit nr.11 për ndotjen, ku duhet të shënohet se ndotja nuk përfshin çështjen e dyoksidit të karbonit, ngase kjo materie duhet të rregullohet me akte të veçanta. Arsyeja pse e bënë këtë propozim është sepse aneksi dy i projektligjit përfshinë elementet klasike të ndotjes. Vërejtja e dytë ishte sa i përket nenit 11.1 ku sipas tij duhet të figuroi viti 2018 në vend të 2017, për shkak se në paragrafin dy është ndryshuar nga komisioni viti prej 2009 në 2010 si dhe për shkak se impiantet duhet të shpenzojnë shumat e konsiderueshme të parave për këto qëllime.

Naser Balaj nga MMPH siguroi komisionin dhe përfaqësuesin e USAID-it se në projektligj asgjë nuk ka nevojë të ndryshohet, ngase dyoksidi i karbonit nuk rregullohet me këtë ligj, por me ligjin për ajrin, prandaj ky ligj nuk mirët me CO2.

Sa i përket nenit 11.1 ai tha se ministri Jagxhillar për shkak të udhëtimit zyrtar nuk prezanton për të thënë qëndrimin politik, por sqaroi se Kosova për shkak të nënshkrimit të traktatit Evropian gjithsesi obligohet me këto gjëra që cekën në nenin 11, ngase të gjitha impiantet në Kosovë duhet të arrijnë standardet evropiane deri në këtë vit që ceket në nen. Personalisht ai nuk ishte kundër të fshihet ky nen. Z. Bill tha se traktati e lenë mundësin për ndryshimin sa i përket shtyrjes së afatit për një vit (2018), por me këtë nuk u pajtua z. Balaj.

Lulzim Zeneli ishte i mendimit se traktatet nuk janë gjithsesi të detyrueshme të obligojnë përmes legjisllacionit tonë, prandaj tha “mos ti lidhim vetë këmbët tona sepse ndotja nuk njehë kufij”. Mendimi personal i tij ishte të hiqet ky paragraf por megjithatë konstatoi se kjo mbetet si çështje e politikës, për çka edhe komisioni deri të martën duhet të shfrytëzoi rastin për konsultime dhe të deklarohet për këtë nen, sepse fjala është për pengesën që i kanoset zhvillimit tonë ekonomik.

Elheme Hetemi tha se për të zbatuar diçka nevojitet mbështetja ligjore (të mbetet neni), ndërsa në anën tjetër ky artikull nuk pengon përfitimet e ndryshme.

Blerim Vela ishte i mendimit se në ligj duhet të shënohet traktati (te neni 11.1), sepse përndryshe do të krijohet precedent. **Ali Lajçi** ishte i mendimit të ngjashëm me kryetarin, ndërsa **Heset Cakolli** u pajtua për konsultime deri të martën. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Të martën më 24.3.2009 komisioni përfundimisht do të jap mendimin për nenin 11.1 të projektligjit të parandalimit e integruar të ndotjes, për çka edhe ministri i MMPH ftohet në këtë takim për shkak të konsulencës politike.

2. Sipas iniciativës së Berat Luzhës (me pajtimin e zyrtarëve të MMPH) :

Fshihet pika c) i paragrafit 1 të Nenit 6, përkatësisht teksti :”c) nuk është shkaktuar ndotje e madhe”.

3..Shqyrtimi i propozimit të komisionit për buxhet për një takim të përbashkët rreth dy projektligjeve në procedurë

Lulzim Zeneli propozoi që takimi i përbashkët me Komisionin për Buxhet të mbahet të martën në orën 12,00 në sallën N-10 lidhur me amendamentet financiare për dy projektligjet e fundit, për Bujqësinë dhe Rrezatimin , me çka u pajtua edhe Komisioni.

4..Shqyrtimi i projektligjit për produktet Biocide.

Kryesuesi konstatoi se edhe kjo pikë do të jetë e gatshme për mbledhjen e radhës, pasi që më parë u njoftua komisioni për ecurinë e punës së grupit nga Elheme Hetemi.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,35, mbledhja e radhës do të mbahet të martën më 24.3.2009.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli